



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

Prishtinë: 17.03.2025

Thirrje publike

për

Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar 2025

Masa 2: Mbështetje financiare për ndërmarrjet mikro dhe të vogla

Nën Masa 2.1: Mbështetje për veprimtaritë zejtare

UDHËZIMET PËR APLIKANTËT

Data e hapjes së thirrjes: 18.03.2025

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve: 31.10.2025

Tabela e përmbajtjes

HYRJE.....	4
Qëllimi i Udhëzuesit.....	4
Përshkrimi i mundësive të aplikimit (projekti)	4
Objektivat e aplikimit.....	5
KUSH MUND TË APLIKOJ?.....	5
Grupi i synuar	5
Kriteret e kualifikimit dhe kërkesat specifike.....	6
Kërkesat specifike për aplikim.....	6
Fushë veprimtaritë e bizneseve mikro.....	7
Manifaktura	7
Artizanale.....	8
SI TË APLIKONI?	9
Hapat e aplikimit	9
Shpjegimi i procedurës	9
Formulari i projekt propozimit	9
Formulari i propozim buxhetit	9
VLERAT E PLANIFIKUARA TË MBËSHTETJES FINANCIARE.....	9
DOKUMENTET DHE INFORMACIONET E KËRKUARA.....	10
Lista e dokumenteve që duhet të dorëzohen.....	10
Udhëzime për mënyrën e dorëzimit	11
AFAFTET E APLIKIMIT	11
Data e hapjes dhe mbylljes së aplikimit.....	11
PROCESI I VLERËSIMIT DHE SELEKTIMIT	11
Metoda e vlerësimit.....	11
Faza e vlerësimit procedural	11
Faza e vlerësimit të përmbajtjes	12
Faza verifikuese në teren	12
Faza e nënshkrimit të kontratave.....	12
Faza e implementimit.....	12
Faza e ankesave.....	13
Kriteret e vlerësimit.....	13
Informacione mbi mënyrën e njoftimit të aplikantëve të përzgjedhur	13
Lista rezervë.....	13
Ankesat.....	14
Dokumentacioni shtesë.....	14
NDIHMË DHE MBËSHTETJE.....	14
Kontakte për pyetje dhe ndihmë	14

Shkurtesat

MZHR	Ministria e Zhvillimit Rajonal
DPKZHR	Departamenti për Planifikim dhe Koordinim të Zhvillimit Rajonal
DBF	Divizioni për Buxhet dhe Financa
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
ARBK	Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës

HYRJE

Qëllimi i Udhëzuesit

Ky udhëzues ka për qëllim të ndihmojë aplikantët në kuptimin e procedurave dhe kërkesave për të aplikuar për mbështetje financiare në kuadër të Masës 2, Nën Masa 2.1, e cila mbështet bizneset mikro dhe veprimtaritë në fushat Zejtari, Manufakturë, Artizanale dhe Inovative.

Veprimtaritë zejtare përfshijnë industrinë e artizanatit, prodhimin e mallrave tradicionale dhe ruajtjen e kulturës dhe trashëgimisë. Këto veprimtari janë të kategorizuara si më poshtë:

- **Mikrozejtaria:** Bizneset që kryejnë aktivitete të vogla prodhimi ose përpunimi, kryesisht me dorë ose mjete të thjeshta. Këto biznese zakonisht operojnë në shkallë të vogël dhe ofrojnë produkte ose shërbime të personalizuar që kërkojnë aftësi të veçanta.
- **Manifaktura:** Bizneset që prodhojnë mallra në sasi më të mëdha se mikrozejtaria, por ende përfshijnë punë manuale dhe mjete gjysmë-mekanike. Këto biznese janë më të organizuara dhe të standardizuara se mikrozejtaria, dhe përqendrohen në prodhimin e mallrave në shkallë më të vogël se industria e madhe.
- **Bizneset artizanale:** Biznese që prodhojnë produkte ose ofrojnë shërbime me dorë, duke përdorur teknika tradicionale ose inovative. Ato operojnë shpesh në sasi të vogla dhe janë të fokusuar në cilësi dhe detaje, duke mbështetur mjeshtërinë dhe kreativitetin.

Përmes këtij programi, synohet përmirësimi i kapacitetit prodhues dhe rritja e mundësive për zhvillimin ekonomik në rajonet përkatëse.

Përshkrimi i mundësive të aplikimit (projekti)

Ky program ofron mundësi për mbështetje të bizneseve mikro dhe veprimtarive Zejtare, Manufakturë, Artizanale dhe Inovative. Ai synon të ofrojë analiza dhe vlerësime për ruajtjen dhe forcimin e kapaciteteve të qëndrueshmërisë së këtyre bizneseve dhe veprimtarive. Programi do të fokusohet në mbështetje për ato biznese që janë në rrezik të mbylljes dhe zhdukjes, duke punuar për krijimin e mundësive të reja për ngritjen e kapaciteteve përmes bashkëpunimit me Qendrat për Zhvillim Rajonal, Universitetet partnere, si dhe me partnerët ndërkombëtarë dhe Ministritë përkatëse. Gjithashtu, ky program mbështet projektet e udhëhequra nga gratë, të rinjtë, të moshuarit dhe komunitetet jo shumicë, dhe inkurajon aplikime nga këto grupe.

Objektivat e aplikimit

Thirrja fokusohet në dy objektiva kryesore:

- I. **Inovacioni, modernizimi i proceseve prodhuese dhe shërbimeve, dhe përmirësimi i kushteve të punës**
 - o Investimi në pajisje moderne dhe teknologji të avancuar për prodhimin dhe ofrimin e shërbimeve, që përmirësojnë efikasitetin, cilësinë dhe kushtet e punës.
 - o Përmirësimi i proceseve të prodhimit dhe shërbimit përmes implementimit të teknologjive dhe metodologjive inovative, të cilat ulin kostot dhe rrisin qëndrueshmërinë e produkteve, si dhe sigurojnë një mjedis pune më të sigurt dhe efikas.
 - o Zhvillimi i shërbimeve të reja ose përmirësimi i atyre ekzistuese, duke përdorur teknologjitë moderne për të optimizuar performancën dhe rritur kënaqësinë e klientëve.
 - o Sigurimi i kushteve më të mira për punonjësit dhe mjedisin e punës përmes pajisjeve dhe mundësive që kontribuojnë në mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë, duke përmirësuar gjithashtu efikasitetin e shërbimeve dhe proceseve prodhuese.
- II. **Krijimi i mundësive të reja të punësimit**
 - o Mbështetje për krijimin e mundësive të reja pune në fushën e artizanatit, përmes përdorimit të pajisjeve të reja që lehtësojnë prodhimin dhe krijojnë mundësi për punësim.
 - o Përfshirja e grupeve të marginalizuara në sektorin e artizanatit, përmes ofrimit të mundësive për trajnime dhe punësim në lidhje me përdorimin e pajisjeve moderne.

KUSH MUND TË APLIKOJ?

Grupi i synuar

Grupi i synuar për këtë thirrje përfshin bizneset mikro dhe veprimtaritë zejtare, artizanale, manufakturë dhe ato inovative që janë të regjistruara dhe operojnë në Kosovë. Ky program është i hapur për biznese që merren me prodhimin e produkteve artizanale, përpunimin e ushqimeve, dhe zhvillimin e bizneseve të vogla, duke ofruar mundësi për mbështetje financiare për rritjen dhe përmirësimin e kapaciteteve prodhuese dhe shërbyese.

Kriteret e kualifikimit dhe kërkesat specifike

Kriteret e aplikimit për këtë thirrje përfshijnë:

- **Regjistrimi i biznesit:** Bizneset dhe veprimtaritë duhet të jenë të regjistruara ligjërisht në Kosovë dhe të operojnë në fushat përkatëse (mikro, artizanal, zejtarë, prodhimi i ushqimeve, etj.).
- **Angazhimi në sektorin e prodhimit dhe shërbimeve:** Bizneset duhet të jenë aktive në sektorin e prodhimit, përpunimit ose ofrimit të shërbimeve dhe të kenë qëllim përmirësimin e kapaciteteve të tyre prodhuese dhe zhvillimin e aktivitetit ekonomik.
- **Veprimtari në fushat specifike:** Aplikantët duhet të operojnë në fushat e zejtarisë, artizanatit, manufakturës dhe inovacionit dhe të ofrojnë produkte apo shërbime që janë të lidhura me këto fusha.
- **Propozimi i një projekti të qëndrueshëm:** Aplikantët duhet të paraqesin një projekt që ka potencial për zhvillim të qëndrueshëm dhe që rrit kapacitetet prodhuese dhe konkurrueshmërinë e biznesit.
- **Përmbushja e kërkesave ligjore:** Aplikantët duhet të kenë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore për funksionimin e biznesit të tyre, përfshirë licencat, lejet dhe tatimet përkatëse.
- **Planifikimi i përdorimit të financave:** Aplikantët duhet të paraqesin një plan të detajuar se si do të përdoren mjetet financiare të kërkuara dhe si do të kontribuojnë ato në ruajtjen e produktivitetit dhe konkurrueshmërisë së biznesit.
- **Përputhshmëria me kriteret specifike të projektit:** Aplikantët duhet të përmbushin kërkesat e tjera specifike që mund të lidhen me sektorin dhe llojin e biznesit për të cilin po kërkohet mbështetje.

Kërkesat specifike për aplikim

Përfituesit/pronarët e bizneseve që kanë përfituar mbështetje financiare nga kjo skemë vitin e kaluar (2024), apo ata që kanë përfituar nga skemat e mëparshme të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB) 2023 dhe 2024, nuk mund të jenë përfitues të kësaj thirrje.

Po ashtu, aplikimi është i pamundur për ata që kanë dështuar në implementimin e projekteve nga skemat e lartpërmendura.

Fushë veprimtaritë e bizneseve mikro

Fushë veprimtaritë që hyjnë te bizneset mikro përfshijnë, por nuk kufizohen në:

Zejtaria

1. Punime artizanale dhe dorëzanat

- Punime me dorë (qilim, qëndisje, punime me grep, etj.)
- Punime me dru (moblie të vogla, suvenire, gdhendje druri)
- Punime me qeramikë dhe argjilë
- Përpunimi i metaleve (bizhuteri artizanale, enë bakri, etj.)
- Punime me lëkurë (çanta, rripa, këpucë artizanale)
- Parukeri dhe berberë

2. Prodhim dhe përpunim ushqimor

- Furre buke dhe pastiçeri artizanale

3. Shërbime dhe zejtari të vogla

- Qepësi dhe riparim i rrobave
- Rrobaqepësi e specializuar (kostume, fustane nusërie, etj.)
- Rimëkëmbje dhe restaurim mobiliesh të vjetra
- Përpunimi dhe riparimi i orëve dhe bizhuterive
- Punime me qelq dhe mozaik.

4. Produkte inovative dhe krijuese

- Prodhimi i sapunëve dhe kozmetikës natyrale
- Punime me printim 3D për produkte të personalizuar
- Prodhimi i qirinjve artizanale
- Dizajn dhe prodhim i lodrave edukative prej druri.

Manifaktura

1. Përpunimi i materialeve të ndryshme

- Përpunimi i drurit për prodhimin e moblieve si tavolina, karrige, rafte, apo moblie të tjera
- Përpunimi i qeramikës për prodhimin e enëve, vazove dhe dekorimeve
- Përpunimi i tekstilit për prodhimin e rrobave, tapete, apo produkte të tjera tekstile në sasi të konsiderueshme.
- Përpunimi i metaleve për prodhimin e veglave bujqësore, dekorimeve metalike.

2. Prodhim dhe paketim i produkteve ushqimore

- Përpunimi dhe ambalazhimi i produkteve ushqimore (miell, makarona artizanale, drithëra, etj.)
- Prodhimi i ëmbëlsirave dhe çokollatave artizanale

3. Prodhimi i artikujve të konsumit

- Prodhimi i këpucëve, rripave, çantave dhe aksesore të tjerë nga lëkura
- Prodhimi i qirinjve, sapunëve dhe produkteve kozmetike natyrale
- Punime artizanale me qelq, kristal dhe porcelan
- Prodhimi i lodrave prej druri ose plastike.

4. Manifaktura në industrinë kreative

- Dizajn dhe prodhim i mobilieve të personalizuar
- Punime në mermer dhe gur për ndërtim dhe dekorim

Artizanale

1. Punime me dorë dhe mjeshtëri tradicionale

- Qëndisje dhe punime tekstili – qilima, perde, mbulesa tavoline, veshje tradicionale
- Punime me grep,thurje dhe endje – shalla, çanta, dekorime tekstili
- Punime me dru – suvenire, kuti druri, objekte dekorative, mobilie artizanale
- Punime me qeramikë dhe argjilë – enë balte, pllaka dekorative, statuja të vogla
- Punime me metal dhe bakër – bizhuteri artizanale, enë bakri, dekorime shtëpiake
- Punime me lëkurë – çanta, rripa, këpucë të punuara me dorë

2. Riparime dhe mirëmbajtje

- Riparimi i automjeteve dhe motoçikletave

3. Përpunimi i ushqimit në mënyrë tradicionale

- Furra artizanale – bukë e bërë në furrë tradicionale, produkte të pjekura me dorë

4. Artizanati në kozmetikë dhe mirëqenie

- Prodhimi i sapunëve natyralë – sapunë bimorë, me vaj ulliri, me bimë medicinale
- Prodhimi i qirinjve artizanale – qirinj me aromë natyrale, qirinj dekorativë
- Kremra dhe produkte kozmetike natyrale – balsame, vajra esenciale, maska natyrale.

5. Artizanati në bizhuteri dhe aksesore

- Prodhimi i bizhuterive artizanale – nga argjendi, bakri, gurë natyralë
- Punime me perla dhe gurë të çmuar – varëse, byzylykë, unaza të punuara me dorë
- Dizajn dhe prodhim aksesorësh unikë – syze artizanale, ora dore të personalizuar.

6. Punime artizanale në industri kreative dhe suvenire

- Piktura dhe vizatime të personalizuar
- Prodhimi i lodrave artizanale prej druri
- Punime me mozaik dhe qelq të ngjyrosur
- Printime dhe dizajn artistik me dorë

SI TË APLIKONI?

Hapat e aplikimit

1. Kompletimi i dokumenteve të kërkuara.

Sigurohuni që të përgatiten dhe të plotësohen të gjitha dokumentet dhe informacionet që kërkohen sipas udhëzimeve të thirrjes për aplikim.

2. Përgatitja e projekt propozimit

Përgatitni një propozim të detajuar për projektin, që përfshin objektivat, aktivitetet, buxhetin dhe planin e zbatimit.

3. Kontrolli dhe verifikimi i aplikimi.

Kontrolloni që aplikimi dhe dokumentet janë të plota dhe të sakta. Të interesuarit mund të aplikojnë të pavarur ose me asistencën e Agjencive për Zhvillim Rajonal (AZHR), dhe Universiteteve partnere të MZHR-së.

4. Formularët dhe materialet përcjellëse

Formularët dhe materialet e nevojshme mund të merren në ueb faqen e MZHR-së në këtë link: <https://mzhr.rks-gov.net/page.aspx?id=1,81>.

5. Dorëzimi i aplikimit

Aplikimi i plotësuar dhe dokumentet mbështetëse duhet të dorëzohen në mënyrën dhe afatin e përcaktuar në udhëzimet për aplikim.

Shpjegimi i procedurës

Formulari i projekt propozimit

Formulari i projekt propozimit duhet të përmbajë informacion të plotë dhe të saktë mbi përmbajtjen e projektit. Është e domosdoshme që të gjitha fushat të plotësohen plotësisht. Fushat që janë të detyrueshme janë shënuar me simbolin (*).

Formulari i propozim buxhetit

Formulari i propozimit të buxhetit duhet të jetë plotësisht i plotësuar dhe të pasqyrojë me saktësi ndarjen e fondeve për secilën fushë të projektit. Sigurohuni që të gjitha shpenzimet të jenë të përfshira dhe të përputhen me kërkesat e thirrjes.

VLERAT E PLANIFIKUARA TË MBËSHTETJES FINANCIARE

vlera totale e planifikuar për këtë thirrje është rreth 50,000.00 euro, e cila mund të rritet në përputhje me disponueshmërinë e mjeteve dhe kualitetin e aplikimeve. Shuma minimale dhe maksimale e mbështetjes janë specifikuar si më poshtë:

- **MZHR do të financojë 100% të vlerës së projekt propozimit.** Megjithatë, aplikantët mund të bashkëfinancojnë projektet e tyre, por jo më shumë se 20% të vlerës së projektit të propozuar.

Shuma minimale e projektit	Shuma maksimale e projektit
1,000.00€	2,500.00€

DOKUMENTET DHE INFORMACIONET E KËRKUARA

Lista e dokumenteve që duhet të dorëzohen

Aplikimi do të konsiderohet i plotë nëse përmban formën e aplikimit dhe anekset e detyrueshme, siç kërkohet në thirrjen publike dhe dokumentacionin përkatës, si më poshtë:

1. **Formulari i aplikimit** (Shtojca A1).
2. **Deklarata për vërtetësinë e dokumenteve** (Shtojca A2).
3. **Plani i veprimit** (Shtojca A3).
4. **Buxheti i projektit** (Shtojca B1).
5. **Dëshmia që aplikanti është shtetas i Republikës së Kosovës.**
6. Aplikanti duhet të jetë **ndërmarrje në pronësi 100% private dhe të regjistruar në Kosovë** sipas ligjeve të Kosovës.
7. **Çertifikatën e regjistrimit të biznesit** me të gjitha fletët/informatat përcjellëse e lëshuar nga ARBK
8. **Vërtetimi tatimor** me validitet në ditën e aplikimit (jo më i vjetër se 90 ditë), që vërteton se aplikuesi nuk ka borxhe tatimore të pashlyera, ose është në marrëveshje për shlyerjen e borxhit me ATK (mund të nxirret online nga ueb faqja e ATK-së).
9. **Lista e punëtorëve** e lëshuar nga ATK për vitin 2024 (mund të nxirret online nga ueb faqja e ATK-së).
10. **Oferta për makineritë/pajisjet e planifikuara për projektin, që përfshin:**
 - Vlerën totale të projektit.
 - Të dhëna të sakta për ofertuesin dhe marrësin e ofertës.
 - Emërtimin dhe specifikimin teknik të saktë të makinerisë/pajisjes.
 - Oferta nuk duhet të jetë më e vjetër se dy (2) muaj nga data e aplikimit dhe duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga ofertuesi.
 - Ofertat janë të preferueshme të jenë në valutën EURO.

Udhëzime për mënyrën e dorëzimit

Projekt propozimet duhet të dorëzohen vetëm në formularët e parashikuar dhe të dorëzohen në arkivin e MZHR-së.

AFAFTET E APLIKIMIT

Data e hapjes dhe mbylljes së aplikimit

Afati për aplikim fillon me datë 18.03.2025 deri me datë 31.10.2025 në orën 16:00. Aplikantit do t'i lëshohet një dëshmi se aplikimi është pranuar brenda periudhës së thirrjes.

PROCESI I VLERËSIMIT DHE SELEKTIMIT

Vlerësimi i aplikacioneve do të realizohet në përputhje me Udhëzuesin për Aplikim dhe Vlerësim. MZHR do të formojë një komision vlerësues, i cili do të jetë përgjegjës për shqyrtimin e aplikacioneve dhe verifikimin e plotësimit të kushteve formale të përcaktuara në thirrjen publike.

Sipas këtij Udhëzuesi, komisioni vlerësues do të trajtojë kërkesat në baza periodike/mujore bazuar në kriteret e miratuara. Në rastet kur aplikimet janë të pakompletuara, komisioni vlerësues mund të kërkojë plotësimin e tyre. Komisioni vlerësues do të paraqesë raporte periodike/mujore (nëse ka aplikime) përmes Sekretarit të MZHR-së dhe do të kërkojë miratimin e tyre nga Ministri i Ministrisë për Zhvillim Rajonal.

Metoda e vlerësimit

Aplikacionet e pranuar do të kalojnë përmes fazave të mëposhtme të vlerësimit.

Faza e vlerësimit procedural

Komisioni vlerësues do të kontrollojë të gjitha aplikacionet e pranuar për të verifikuar nëse ato i plotësojnë kushtet formale të thirrjes publike. Pas kontrollit, komisioni do të përgatisë dy lista:

- Lista e aplikantëve që plotësojnë kushtet për vlerësim të përmbajtjes së projekteve të tyre.
- Lista e aplikantëve që nuk i plotësojnë kushtet dhe arsyeja e refuzimit do t'u dërgohet me shkrim.

Faza e vlerësimit të përmbajtjes

Aplikantët që kalojnë fazën procedurale do të vlerësohen nga komisioni në përputhje me Udhëzuesin dhe formularët përkatës të vlerësimit. Komisioni vlerësues përgatitë listën paraprake të përfituesve.

Faza verifikuese në teren

DPKZHR do të vizitojë biznesin e para-kualifikuar për të verifikuar vërtetësinë dhe qëndrueshmërinë e ambienteve të punës, pajisjeve dhe mjeteve të nevojshme për zbatimin e projektit.

Faza e nënshkrimit të kontratave

Pas miratimit të aplikacioneve, do të nënshkruhen kontratat midis MZHR-së dhe aplikantëve të miratuar.

Faza e implementimit

- Pas nënshkrimit të kontratës, do të fillojë faza e implementimit të projekteve.
- Afati i implementimit të projektit është 3 muaj nga dita e nënshkrimit të kontratës, përveç nëse është parashikuar ndryshe në kushtet e kontratës.
- Veprimet duhet të ndërmerren brenda Rajonit Zhvillimor të prezantuar në aplikim.
- Përfituesi i projektit duhet të informojë Departamentin e Planifikimit dhe Koordinimit të Zhvillimit Rajonal (DPKZHR) mbi zbatimin e projektit së paku dy javë para skadimit të afatit të Garancionit bankar. Mos zbatimi në kohë mund të sjellë masa ndëshkuese.

Rajonet zhvillimore dhe Komunat

Rajoni Zhvillimor		Komunat
(01)	Qendër	Prishtinë, Podujevë, Obiliq, Fushë Kosovë, Lipjan, Glogoc, Graçanicë
(02)	Veri	Mitrovica e Jugut, Skenderaj, Vushtrri, Zveqan, Leposaviq, Zubin Potok, Mitrovica Veriore
(03)	Perëndim	Pejë, Istog, Klinë, Deçan
(04)	Jug	Prizren, Suharekë, Dragash, Mamushë
(05)	Juglindje	Ferizaj, Shtime, Kaçanik, Shtërpçë, Hani i Elezit
(06)	Lindje	Gjilan, Kamenicë, Viti, Novobërda, Partesh, Ranillukë, Klllokot
(07)	Jugperëndim	Gjakovë, Rahovec, Malishevë, Junik

Faza e ankesave

Pas publikimit të rezultateve, aplikantët mund të adresojnë ankesat e tyre në **arkivin e MZHR-së**.¹

Kriteret e vlerësimit

Pjesa / Elementet e notimit	Vlera e përgjithshme/Pikët maksimale
1. Kapaciteti financiar dhe operacional	20
2. Relevanca e veprimit	25
3. Efektshmëria dhe arritshmëria	25
4. Qëndrueshmëria e veprimit	15
5. Buxheti dhe efektshmëria në kosto	15
GJITHSEJ PIKË (MAKSIMUM)	100

Informacione mbi mënyrën e njoftimit të aplikantëve të përzgjedhur

Pas përfundimit të vlerësimit, rezultatet paraprake do të publikohen si vendim në uebfaqen e MZHR-së dhe do të njoftohen me shkrim të gjithë aplikantët.

Rezultatet paraprake do të konkretizohen me Kontratë, përveç në rast se paraqitet ndonjë ankesë e bazuar dhe e konfirmuar nga Komisioni i Ankesave ose nuk e kalojnë fazën e tretë (verifikuese në terren). Pra, nëse paraqitet ankesa, rezultatet paraprake do të bëhen përfundimtare pasi të trajtohen ankesat e aplikantëve.

Lista rezervë

Aplikimet me pikët më të larta do të përzgjidhen si përfitues deri në shpenzimin e plotë të buxhetit në dispozicion.

Pas shpenzimit të buxhetit, aplikantët që kanë arritur së paku 50 pikë dhe më shumë, do të mbeten në listën e pritjes/rezervë. Aplikantët do të renditen sipas pikëve që kanë fituar, duke filluar nga ata me më shumë pikë deri tek ata me më pak pikë të fituara.

Lista rezervë do të mbetet e vlefshme për vitin fiskal 2025.

¹ Në pajtim me parimet dhe rregullat e përcaktuara me Ligjin nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative

Ankesat

Aplikantët kanë të drejtë të ushtrojnë ankesë kundër vendimit të Komisionit Vlerësues pranë Komisionit të Ankesave.

Të gjitha ankesat në lidhje me thirrjen publike duhet të dorëzohen në kopje fizike në arkivin e MZHR-së, nga aplikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar².

Komisioni i Ankesave do të shqyrtojë dhe do të marrë vendimin për ankesat.

Dokumentacioni shtesë

Para nënshkrimit përfundimtar të kontratës dhe në bazë të vlerësimit të Komisionit, MZHR do të kërkojë dokumentacion shtesë nga aplikantët, i cili përfshin:

- Klasifikimi i aplikantit në Regjistrin e Kredisë Kosovës (CRK – Credit Registry of Kosovo) për llogaritë personale dhe të biznesit, duke u renditur nën kategorinë B.
- Konfirmimi nga banka për llogarinë aktive të biznesit (*konfirmimi duhet të jetë nxjerrë gjatë periudhës kur thirrja publike është ende e hapur*).

DPKZHR do të kontrollojë dokumentacionin shtesë. Nëse aplikanti nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar brenda afatit të caktuar (jo më pak se 10 ditë), aplikimi do të refuzohet.

Nëse pas kontrollimit të dokumenteve mbështetëse rezulton se disa aplikantë nuk i plotësojnë kushtet e kërkuara nga thirrja publike, ata nuk do të merren parasysh për nënshkrimin e kontratës.

NDIHMË DHE MBËSHTETJE

Kontakte për pyetje dhe ndihmë

Të gjitha pyetjet në lidhje me thirrjen mund të bëhen vetëm në mënyrë elektronike në email-in: dpkzhr@rks-gov.net Përgjigjet do të publikohen në faqen zyrtare të MZHR-së.

² Në pajtim me parimet dhe rregullat e përcaktuara me Ligjin nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative